

UDHËZIM
Nr.44, datë 17.11.2009

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të neneve 35 e 58 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, pas pikës 20.2 “*Rimbursimi për marrëveshjet financiare*”, shtohet pika 20.3 me përmbajtjen e mëposhtme:

“**20.3.**Në rastin e zbatimit të Marrëveshjeve kuadër “Mbi bashkëpunim dhe zhvillim”, midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, financimet në kuadër të këtyre marrëveshjeve janë të përjashtuara nga TVSH-ja. TVSH-ja do të financohet nga përfituesi vendas në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe faturohet e paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e furnizimeve për zbatimin e projektit. Skema e aplikimit të TVSH-së do të bëhet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.509, datë 12.8.1996 “Për mënyrën e përballimit të TVSH-së që lidhet me zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë e organizma të ndryshëm ndërkombëtarë. Përjashtimi nga TVSH-ja për entet zbatuese të marrëveshjes kuadër të bashkëpunimit dhe zhvillimit, bëhet vetëm në rastet e përjashtimeve të parashikuara në nenet 20-26/1 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për TVSH-në”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode